



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, pikes 14 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.28/96 të datës 14.09.2022, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR KURSIM TË ENERGISJË

Neni 1

Me këtë Vendim, **Enver Elshani**, Zyrtar në Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për kursimin e energjisë sipas pikes 14 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.28/96 të datës 14.09.2022.

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të kryej detyrat për kursimin e energjisë në territorin e Komunës së Lipjanit, duke i kryer të gjitha detyrat që janë të përcaktuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.28/96 të datës 14.09.2022 për masat detyruese për kursim të energjisë në institucionet e nivelit qendror, lokal dhe nëmarrjet publike.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet zyrtari Enver Elshani dhe Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

1Nr. 112/02-52935
Lipjan, më 03.10.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,720.00€**, (gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-52991 të datës 03.10.2022, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 32 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shtator të vitit 2022 me nga 210 euro për secilin rast $32 \times 210 = 6,720.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI – dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-52991

Lipjan, më 04.10.2022





Pranuar me: Primljeno:	05.10	20	22
Njësia Jednica:	Numri Seri:	Shtojca Dodatak	
1-112/02-53904			

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 dhe në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024 të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nr. 27.29 të datës, 14.09.2022, Kryetari i Komunës nxjerr:

V E N D I M

1. Zyrtar përgjegjës për procesin e barrës administrative në kuadër të Komunës së Lipjanit, caktohet **SHEMSI AZEMI**, në pozicionin e punës Shef i Sektorit për Tatim në Pronë –Drejtorati për Buxhet dhe Financa si dhe Koordinator i grupit për Performancë.
2. Përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative, janë:
 - 2.1. Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda Komunës;
 - 2.2. Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës;
 - 2.3. Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative;
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

IMRI AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit



Vendimi iu dërgohet:

1. Z.Shemsi Azemi
2. Zv. Sekretares së MAPL
3. Zyrës për Planifikim Strategjik/ZKM
4. Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullore MF- nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Doracakut të Procedurave të MFK-së pika 4 – Procedurat e MFK-së Nr.4 – Menaxhimi i Rrezikut si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR CAKTIMIN E ZYRTARES PËR IDENTIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E RREZIKUT
PËR VITIN 2022 SIPAS PROCEDURAVE TË MFK-SË

Neni 1

Me këtë Vendim, **Shehadije Ibrahim**, zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa **CAKTOHET**, Zyrtare për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut për vitin 2022, sipas procedurave të MFK-së.

Neni 2

Nëpunësja civile e caktuar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të kryej punët dhe detyrat si detyrë shtesë krahas detyrave të punës, konform Rregullore MF- nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe Doracakut të Procedurave të MFK-së.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe dhe Nëpunësja civile e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

1Nr. 112/02-54076
Lipjan, më 06.10.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar edhe në kërkesën e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.020/01-53289 të datës 04.10.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

I.SHKËLQIM BAHTIRI nga IPKO Foundation-Qendra në Lipjan, i përzgjedhur konform Ftesës Publike për Aplikim 1Nr.453/01-52077të datës 26.09.2022, EMËROHET, person përgjegjës në cilësinë e ekspertit për monitorimin e punës të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Lipjanit.

II. Eksperti për punën e tij do të kompensohet, për secilin takim që ftohet nga ana e Komisionit, në vlerën e njëjtë me anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Lipjanit të caktuar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-40406 për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Lipjanit të datës 28.07.2022.

III.Vendimi hyn në fuqi menjëherë

Vendimi i dërgohet:

Shkëlqim Bahtirit
Imri Semetishtit, Kryesues i Komisionit

1Nr. 453/01-54325
Lipjan, më 06.10.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË
STUDENTËVE PËR NDARJEN E BURSAVE

Neni 1
Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të studentëve për ndarjen e bursave të cilët kanë aplikuar sipas Konkursit publik të shpalluar nga Drejtorati për Arsimit me Nr.4-111/01-52779 i datës 30.09.2022, në përbërje si vijon:

1. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsimit, Kryesues
2. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsimit, anëtar
3. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit


1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e studentëve për ndarjen e bursave brenda afatit 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit publik, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, dhe kriterëve të përcaktuara në Konkursin publik.
2. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni shpallë listën preliminare në faqen zyrtare të Komunës ndërsa pas përfundimit të procedurave të ankesave Komisioni vlerësues shpallë listën përfundimtare të përfituesve.
3. Punët administrative- teknike për Komisionin do të kryej Drejtorati për Arsimit.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit me kopjen e të cilit do të njoftohen DKA, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-54698
Lipjan, më 07.10.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 , Kryetari i Komunës, merr

VENDIM
PËR THEMELIMIN EKOMISIONIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

Neni 1

Themelimi dhe Përbërja

Me këtë Vendim themelohet Komisioni Komunal për rintegrimimin e personave të riatdhesuar (në vazhdim të tekstit komisioni) në përbërje , si vijon:

1. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesues
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Rozeta Selimi, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
4. Ismet Gashi, Enti për punësim-Lipjan, anëtar
5. Xhelil Murati , Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
6. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
7. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
8. Linda Shahini, Zyrtare për Integritim Evropiane anëtare,
9. Fatmir Goliqi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtar
10. Lorik Bërbatovci, Qendra për punë sociale, anëtar
11. Hasan Luma , NJDNJ dhe barazi gjinore

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Komisioni merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegritimit si në vijim:

1. akomodim me qira;
2. asistencë mjekësore;
3. rindërtim dhe/ose renovim të shtëpive;
4. pako të orendive shtëpiake.

Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar në harmoni me Rregulloren (QRK) Nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe me Ligjin për Procedurë të Përgjithshme Administrative. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve prezentë, brenda afatit sa më të shkurtër kohor por jo me vonë së shtatë (7) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës për skemat emergjente.. Për skemat tjera, Komisioni merr vendim brenda periudhës kohore prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. Vendimi i Komisionit i dërgohet parashtresit të kërkesës jo më vonë së shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij nga kryetari i komunës. Komisioni diskuton dhe adreson sfidat e personave të riatdhesuar për qasje në shërbime publike dhe riintegrim të qëndrueshëm.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyra Lokale për Komunitete dhe anëtarët e Komisionit . Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohen të gjitha Vendimet paraprake për themelimin ose ndyshim plotësimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Komunal për riintegrimin e personave të atdhesuar .

1Nr. 020/04-54604
Lipjan, më 07.10.2022

IMRI AHMETI
KRYETARI I KOMUNËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në kërkesën me 1Nr.630-43898 të datës 16.08.2022, Kryetari i Komunës merr :

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN , ARKIVIMIN DHE
ASGJËSIMIN E LËNDËVE NË ARKIVIN KOMUNAL**

**Neni 1
Përbërja e Komisionit**

Formohet, Komisioni për verifikim dhe arkivim të lëndëve si dhe asgjësim të lëndëve në arkivin komunal për në objektin e ri të qytetit në përbërje si vijon:

1. Kumrije Reçica, Drejtorati për Administrat, kryesuese
2. Enver Haziri, Drejtorati për Kultur,Rini dhe Sport, anëtar
3. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kultur,Rini dhe Sport, anëtar
4. Ramadan Hoxha, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
5. Jalldyze Gashi- Kallaba, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,anëtare

**Neni 2
Detyrat e Komisionit**

Detyrë e Komisionit është verifikimi dhe arkivimi të lëndëve si dhe asgjësimi i lëndëve në arkivin komunal për në objektin e ri të qytetit. Komisioni do të kryej detyrat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Arsyetim

Bazuar në kërkesen me Nr1-630-43898 të datës 16.08.2022 të drejtoratit për administratë, marr parasysh gjendjen e arkivës në komunë që është shumë e ngarkuar me lëndë, si dhe kushtet e ruajtjes së lëndëve në këtë arkiv nuk i plotëson kushtet elementare, objektit i dominon pluhuri, lagështia si dhe në përgjithësi siguria duhet të jetë në nivel të lartë.Andaj duhet që bazë të procedurave të fillojnë për arkivimin dhe barjtjen e lëndëve për në arkiven e qytetit.

1Nr.630-43898
Lipjan, më 10.10.2022.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve , si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për organizimin e Festivalit për Fëmijë "Lipjani 2022", në përbërje si vijon:

1. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ganimete Osmani, nga OJQ-të, anëtare
5. Fidan Tmava, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Teuta Berisha, Drejtorati për Arsim, anëtare rezerv

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve organizimin e Festivalit për Fëmijë "Lipjani 2022", që kanë aplikuar konform Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453/01-45965 të datës 23.08.2022, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.


**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 453/01-55032
Lipjan, më 10.10.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrotjtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, nenit 17 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit për për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Haqif Rrustemi, Kryesues
2. Hasan Hajdini, anëtar
3. Gafurr Hetemi, anëtar
4. Albert Mustafa, anëtar
5. Bekim Zaskoku, anëtar
6. Rafete Retkoceri, anëtare
7. Jalldyze Gashi, anëtare
8. Afrim Sadiku, anëtar
9. Behar Mjeku, anëtar
10. Enver Elshani, anëtar
11. Brahim Duriqi, anëtar
12. Labinot Dedushi, anëtar

Në rast nevoje gjatë fazës së hartimit mund të angazhohen edhe ekspert të jashtëm të cilët do ta plotësojnë grupin punues të cilët do të përzgjidhen përmes një procedure të thjeshtë të konkurimit.

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft- Planit për për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit më së largu me datë 05.11.2022.
2. Pas hartimit të Draft- Planit, grupi punues është i obliguar që draftin final pas konsultimit të publikut ta dërgojë paraprakisht në AME -Agjencia e Menaxhimit Emergjent për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor dhe pas marjes së opinionit nga AME e procedon për miratim në Kuvendin Komunal.
3. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për hartimin e Draft-Planit për për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.020/04-52669 i datës 29.09.2022.

1Nr.020/04-52669/2
Lipjan, më 17.10.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËSE PËR PROJEKTIN E BUJQËSISË ME
ORGANIZATËN (QATAR CHARITY)

Neni 1

Caktimi i Personit Përgjegjës

Me këtë Vendim, **Rexhep Rexhepi**, Drejtor në Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, **CAKTOHET** – Person përgjegjës për projektin e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari dhe Organizatës “QATAR CHARITY” sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit nr.1-660/103-47252 të datës 31.08.2022 e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “QATAR CHARITY”.

Neni 2

Detyrat Personit Përgjegjës

Personi përgjegjës është e obliguar të bashkëpunojë me Organizatën (**QATAR CHARITY**) për të gjitha procedurat për zbatimin e projektit e Marrëveshjes së bashkëpunimit nr.1-660/103-47252 të datës 31.08.2022 e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “QATAR CHARITY” si dhe të bashkëpunojë për procedurat e aplikacioneve të fermerëve sipas ftesës publike për aplikim nr.1-66/03-49074 të datës 12.09.2022 për aplikacionet si në vijim: Sera bujqësore për kultivim, Frezë dheu për traktor, Kositëse bari për traktor, Krerë gjedhe dhe Kope delesh.

Neni 3

Hyrje në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Organizata (QATAR CHARITY).

1Nr. 112/02-56860
Lipjan, më 18.10.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR
VERIFIKIMIN, ARKIVIMIN DHE ASGJËSIMIN E LËNDËVE NË ARKIVIN
KOMUNAL**

I.Me këtë Vendim, **zëvendësohet**, anëtari i dytë i Vendimit për emërimin e për formimin komisionit për verifikimin, arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve në arkivin komunal i caktuar sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.630-43898 i datës 10.10.2022 dhe në vend të tij caktohet:

ARMEND DURIQI, Zyrtar në Drejtoratin për Gjeodezi Dhe Kadastër

II.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:
Kryesueses së komisionit , Kumrije Reçica
Zyrtari Armend Duriqi

1Nr.630-43898/2
Lipjan, 25.10.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË KOMUNËN E LIPJANIT

I. Me këtë Vendim, THEMELOHET, Ekipi për të drejtat e fëmijëve në Komunën e Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, kryesues i Ekipit
2. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, zëvendës kryesues i Ekipit
3. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
4. Albert Mustafa, Shef i Sektorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
5. Anila Reçica-Llugiqi, Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
6. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, anëtar
7. Daut Azemi, Kryesues i komitetit për politikë dhe Financa, anëtar
8. Skender Bikliqi, Kryesues i komitetit për komunitete, anëtar
9. Fjolla Ibrahim, Zyrtare për Mbrojtjen e fëmijëve-QPS, anëtare
10. Florentina Murtezi, policia- Lipjan, anëtare
11. Lorik Berbatovci, Qendra për punë Sociale, anëtar
12. Bekim Krasniqi ,përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar

II.Ekipi për të drejtat e fëmijëve do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me dispozitat e Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.

III.Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet

Kryesuesit zëvendës kryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të ekipit

INr. 020/05-58800

Lipjan, më 31.10.2022

